# Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
## Odeljenje za Zaštitu i Spašavanje
## Department of Protection and Rescue

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. I prot / Br. prot. 2045 Më / Dt. 01.07 2019

# MBROJTJA NGA ZJARRI

Shpëtimi i jetës dhe i pasurisë

Qytetarë të nderuar

Stina e verës sjell temperatura të larta të ajrit, të cilat e shtojnë rrezikun për shfaqjen e zjarreve në zonat malore, fushore si dhe në vendbanime. Duke pasur parasysh pasojat e katastrofave që mund të vijnë nga shpërthimet e zjarreve, përfshirë edhe jetën e njerëzve.



## APELOJMË

Të jemi të kujdesshëm dhe vigjilent për shmangijen e gjithë shkaktarëve të mundshëm të zjarrit. Zjarri mund të shkaktohet me një fije shkrepëse, por nuk mund të shuhet me ekipe të tëra të zjarrfikësve, përderisa pasojat mund të jenë të pa parashikueshme. Vëzhgimi lajmërimi dhe alarmimi me kohë i shfaqjes së zjarrit do të mundësojë intervenimin e shpejtë dhe efikas të Shërbimeve Zjarrfikëse dhe ekipeve të shpëtimit në lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit. Si duhet të veprojmë në rast zjarri:

- Qëndro i qetë dhe mos bë panik!
- Thirr numrin 112 dhe lajmëro zjarrin ( prezantohu, trego vendin e saktë, adresën dhe ndërlidhe atë me ndonjë objekt të rendësishëm, mbaje linjën telefonike të lirë). Nëse zjarri është në fazën fillestare provo të e shuash duke përdorur batanije, shtroje, ujë, rërë apo aparatin për fikje të zjarrit. Zjarret e shkaktuara nga ryma nuk guxojnë të shuhen me ujë. Këto zjarre shuhen me anë të aparateve për fikje të zjarrit të mbushura me $CO_2$.
- Shkyçe ndërprerësin kryesorë nëse mund ti qasesh!
- Nëse zjarri përfshin rrobat e trupit atëherë mbulohu me një batanije ose shtrihu në dysheme dhe rrokullisu.
- Në rast të shfaqjes së tymit qëndro në shtëpi dhe përdorë gjëra të lagura , mbylli të gjitha të çarat, vrimat nga mund të hyjë tymi në dhomë.
- Qëndro sa më poshtë që mundesh, nëse është e nevojshme shtrihu në dysheme që të ikësh tymit
- Kur të arrijnë zjarrfikësit sinjalizoi për vendndodhjen tënde.
- Gjatë gjithë kohës qëndro në linjë telefonike m numrin emergjent 112.

## Informimin mund ta bëni në:

- Qendrën e Alarmimit nëpërmjet numrit të integruar emergjent – 112. Numrin emergje 112 mund ta thirrni dhe ta merrni pa prefix nga çdo vend apo pozitë ( tunele, puse, podrume, humnera, etj) në Republikën e Kosovës.
- Shërbimin për Zjarrfikës dhe Shpëtim mur ta merrni në numrin fiks 93 , ndërsa me telefon celular prej VALËS 193 dhe prej telefonit celular të IPKO-s 933.
- Policinë e Kosovës mund ta merrni në numrin e telefonit fiks 92 dhe 192 në telefon celulare.
- Ndihmën e shpejt mjekësore mund ta merr në numrin e telefonit fiks 94, e celulare prej VALËS 194 dhe IPKO-s 944.

Të gjitha thirrjet telefonike emergjente në numrin fiks dhe celulare janë falas.

Ligji për Mbrojtje nga Zjarri nr. 04/L -027 i obligon të gjithë qytetarët që të ndërmarrin t gjitha masat për mbrojtje nga Zjarri.